



Dalës-Izleazne

Nr. X-173  
Br. X-173

Data 14.03.2022  
Datum

MASHTI-IT



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

### Drejtoria e Arsimit

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, të Ligji i Punës, nr.03/L -212, neni 5, paragrafi c, Ligji për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, neni 35, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr.04/L-032, Udhëzimet Administrative , i MASHTI-it Nr.5/2021, dhe i MPMS , Nr. 07/2017 dhe kërkesën me nr. -X-172, e datës 14.03.2022, Drejtoria e Arsimit me datë 14.03.2022, rishpall :

### KONKURS

( Për plotësimin e vendeve të punës)

- SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova " në Obiliq  
Vendet e punës : Dy asistentë për fëmijët ,nxënësit me nevoja të veçanta njëri,lëvizës edhe në shkollat tjera
- SHFMU"Hasan Prishtina " në Milloshevë  
Vendi i punës:Një asistent për fëmijët,nxënësit me nevoja të veçanta

Detyrat për asistentë të fëmijëve, nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

- Ndhmon fëmijët, nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë.
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e Planit Individual të Arsimit, PIA-së, lëndët të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve.
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës.
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgatitë informata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve, nxënësve.
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës

Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët,nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike, personale, mjekësore dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre

- Promovon bashkëpunimin shkollë – shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin e kujdestarin.
- Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve.
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve.
- Informacionet në shkollë i trajtojnë si plotësisht konfidenciale.

**Kualifikimi për asistentë për fëmijët, nxënësit me nevoja të veçanta:**

Shkolla e Mesme dhe Niveli 5-të (Postsekondar) i kualifikimit asistent për fëmijë, nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativet të MASHT-it në fuqi.

**Kualifikimi për punëtor teknik: shkolla e mesme e lartë (SHML)**

Kandidatët që konkurojnë për asistentë për fëmijët, nxënësit me nevoja të veçanta duhet ta sjellin kopjen e diplomës së shkollës së mesme dhe nivelin e 5-të (Postsekondar) të noterizuar, vërtetimin për përvojën e punës, certifikatën e lindjes, dokumentin e letërnjoftimit.

Kandidatët, që konkurrojnë për këto vende të punës, të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, të cilët nuk i kanë diplomat e nostifikuara në MASHT nuk do të përfshihen në listën e ngushtë.

Fletëkërkesat merren në Zyrën e Pritëse të KK-së, apo në faqen zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumentet të kompletuara në të njëjtën zyrë. Kandidatët do të ftohen në intervistë përmes telefonit.

Afati i konkursit është 15 ditë nga dita e publikimit në shtyp dhe te faqja zyrtare e komunës.

Drejtori : Sahit Zeqiri

